

 <small>TITAN Group Company</small>	POLITIKA E PËRGJEGJËSISË SOCIALE	Kodi: PPS/1
		E vlefshme prej: 01.01.2016
		Faqja: 1 of 1

Vlerat Tona

SHARRCEM është pjesë e kompanisë greke TITAN Group dhe si e tillë ushtron aktivitetin e saj në prodhimin e produktit të çimentos dhe ka si qëllim të menaxhojë dhe të promovojë në mënyrë efektive vlerat e korporatës të Grupit TITAN, duke përfshirë integritetin, aftësitë, vlerat ndaj klientëve të saj, rezultatet që përfitohen, vetë - përmirësimin e vazhdueshëm si dhe përgjegjësitë e korporatës mbi efektet që i sjellin shoqërisë dhe mjedisit marrja e vendimeve dhe kryerja e veprimtarive, nëpërmjet sjelljes transparente dhe etike, e cila:

- jep kontribut në zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë shëndetin dhe mirëqënien e shoqërisë;
- merr në konsideratë pritshmëritë e aktorëve përfshirës;
- është në përputhje me ligjet e aplikueshme dhe në pajtueshmëri me normat ndërkombëtare të sjelljes; dhe
- është e integruar në mbarë organizatën dhe është praktike në marrëdhëniet që ajo krijon, duke zbatuar Kodin e Sjelljes të Grupit TITAN dhe sistemet matëse të Përgjegjësisë Sociale të Korporatave (PSK).

Përkushtimi Ynë

SHARRCEM është e përkushtuar të menaxhojë veprimtaritë e saj në përputhje me të gjithë legjislacionin përkatës të punës. Me qëllim për të mbështetur implementimin e vlerave të saj, SHARRCEM zbaton Kodin e Sjelljes të TITAN Group dhe miraton standartin ndërkombëtar SA 8000 për menaxhimin e përgjegjësisë sociale gjatë kryerjes së veprimtarive të saj.

Parimet Tona

SHARRCEM në mënyrë të vazhdueshme identifikon, vlerëson, menaxhon dhe përmirëson elementët e veprimtarisë së saj që ndikojnë tek përgjegjësia sociale. Në linjë me praktikën e biznesit, SHARRCEM përkushtohet të përmbushë sa më poshtë vijon:

- Të zbatojë këtë politikë e cila është dokumentuar, implementuar, mirëmbajtur, komunikuar në mënyrë efektive dhe i është transmetuar në mënyrë të kuptueshme të gjithë personelit, qofshin të punësuar, të kontraktuar ose të cilët përfaqësojnë Kompaninë;
- Të kryejë veprimtarinë e saj në mënyrë të drejtë, të ndershme, duke treguar integritet dhe duke respektuar interesat e aktorëve të përfshirë.
- Të zbatojë të gjitha kërkesat e përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në vend, në lidhje me Përgjegjësinë Sociale në vendin e punës si dhe konventat përkatëse ndërkombëtare, si konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Të sigurojë trajnime ndërgjegjësuese në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe nëse është e nevojshme t'u sigurojë punonjësve trajnim të veçantë;
- Të shmangë përdorimin e fëmijëve për punë si dhe punësimin më forcë dhe atë të detyruar; të përmirësojë shëndetin dhe sigurinë; të mbështesë lirinë për të marrë pjesë në shoqata dhe në negociata kolektive, të shmangë diskriminimin; të zbatojë menaxhimin e performancës dhe të menaxhojë kompensimin dhe orët e punës;
- Të nxisë furnizuesit dhe kontraktorët që të mbështesin parimet dhe përkushtimin e saj në lidhje me përgjegjësinë sociale dhe të prezantojë programe me qëllim për të mbështetur këto parime;



 	POLITIKA E PËRGJEGJËSISË SOCIALE	Kodi: PPS/1
		E vlefshme prej: 01.01.2016
		Faqja: 2 of 1

- Të zbatojë një sistem menaxhimi që krijon përgjegjësitë, politikat mbështetëse, metodat e monitorimit dhe rishikimin e procesit të performancës së saj.

Kontrolli dhe Rishikimi i Politikave

Kopje të kësaj politike janë vendosur në të gjithë ambientet e SHARRCEM-it. Kjo politikë i është komunikuar secilit punonjës dhe disponohet për të gjithë palët e interesuara. Politika do të rishikohet në bazë vjetore nga niveli drejtues dhe çdo ndryshim i saj do të miratohet nga Drejtori Gjeneral dhe do të komunikohet nga personi i cili është përgjegjës për Sistemin e Menaxhimit të Përgjegjësive Sociale.

Adresa e Trupit Çertifikues

EURO CERT

89 Chlois and Likovriseos Str.
Metamorfosi
144 52, Athens / Greece
Tel: ++30 210 62.52.495, 62.53.927
Fax: ++30 210 62.03.018
e-mail: info@eurocert.gr

SOCIAL ACCOUNTABILITY INTERNATIONAL

New York, USA
Phone: 212-684-1414
Fax: 212-683-8867
Email: info@sa-intl.org

Menaxher i HR dhe CSR
Vigan Sylejmani



Drejtor Menaxhues
Thomas Glavas

